

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 361P Prot

Tiranë, më 15, 06, 2020

URDHËR

Nr. 181, datë 15, 06, 2020

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT VJETOR TË INSPEKTIMIT TË NOTERËVE PËR
VITIN 2020”


Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, e ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar dhe të nenit 25 të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve për vitin 2020, sipas programit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Sekretari i Përgjithshëm, për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI
ETILDA GJONAJ (SALIU)



PROGRAMI VJETOR I INSPEKTIMIT TË NOTERËVE PËR VITIN 2020

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky akt ka për qëllim organizimin e një programi vjetor inspektimi për noterët, duke bërë edhe përcaktimet në afatet kohore lidhur me inspektimet.

Nëpërmjet këtij akti përcaktohen afatet kohore të inspektimit të çdo zyrë noteriale, dhe që do të kryhet me intervale të rregullta, por jo më pak se një herë çdo katër vjet.

Neni 1

Objektivat e programit vjetor të inspektimit të noterëve

1. Programi vjetor i inspektimit të noterëve ka si qëllim të garantojë kryerjen e detyrave prej noterit në përputhje me ligjin, duke u udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Objektivat e programit vjetor arrihen nëpërmjet:
 - a) vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga noterët në përputhshmëri me standardet e parashikuara në legjislacionin në fuqi, besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit;
 - b) dokumentimit të praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore dhe përhapjen e tyre duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, procedurave dhe kontroleve, pra sistemin e menaxhimit;
 - c) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut që rrjedh nga ushtrimi i profesionit të noterit, nga Ministria e Drejtësisë dhe autoritetet e tjera shtetërore.
 - d) monitorimin/kontrollin e veprimtarisë së noterit në lidhje me zbatimin e ligjit, standardet e sjelljes profesionale, veçanërisht zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
 - e) këshillimit të noterit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore, për të parandaluar moszbatimin e kërkesave ligjore;
 - f) korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre, duke mbajtur parasysh masën dhe efektin e dëmtimeve të shkaktuara;
 - g) dokumentimin e shkeljeve disiplinore dhe përfundimin e procedurave hetimore në përputhje me legjislacionin në fuqi me qëllim propozimin e masave disiplinore për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, të parashikuar nga ligji i noterisë apo legjislacioni i posaçëm.



2. Programi i inspektimeve, në varësi të intervalit kohor 1 vjeçar, përcakton elementë të ndryshëm si vijojnë:
 - a) programi vjetor i inspektimeve bëhet mbi bazë tematike (lloji i problematikave si aplikimi i tarifave, hedhja e akteve në sistem, etj) dhe ka për qëllim planifikimin sasior të akteve të inspektimit dhe përcaktimin e tematikave të inspektimit gjatë vitit.
 - b) programi mujor i inspektimeve bëhet mbi bazë subjektesh dhe ka për qëllim planifikimin e akteve të inspektimit dhe përcaktimin e noterëve që do të inspektohen gjatë muajit.
 - c) programi javor i inspektimeve bëhet mbi bazën e noterëve të planifikuar për muajin përkatës dhe ka për qëllim planifikimin e noterëve që mbikqyren deri në përmbushjen e detyrimit që lind nga neni 25, i ligjit "Për noterinë".

Neni 3

Programi vjetor i inspektimeve për vitin 2020

1. Për vitin 2020, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë të kryejë inspektimin e jo më pak se 50 noterëve.
2. Inspektimet për vitin 2020 të kryhen në kontrollin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në veprimtarinë e noterit në fushat e mëposhtme:
 - përmbushja e detyrimeve nga noterët që rrjedhin nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kontratat e sipërmarrjes dhe kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme;
 - regjistrimi i veprimeve noteriale në regjistrat noterial dhe në Regjistrin Noterial Shqiptar;
3. Inspektimet për vitin 2020 të kryhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke pasur në konsideratë që gjatë periudhës/stinës së dimrit të inspektohen subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ultësirën perëndimore ku është edhe më e lehtë arritja në vendndodhje, si dhe për të llogaritur dhe maksimizuar sa më shumë dhe me efikasitet numrin e noterëve, të cilët i nënshtrohen inspektimit.

Neni 4

Programi mujor i inspektimeve

1. Programi mujor i inspektimeve përcakton subjektet/noterët që i nënshtrohen mbikqyrjes, bazuar në programin vjetor të inspektimeve, ku për çdo muaj përcaktohen në mënyrë sasiore numri i noterëve të ndarë sipas tematikave/bashkive duke pasur në konsideratë kriteret e mëposhtme:
 - a) kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e inspektimeve sipas subjekteve. Kjo pasi çdo akt inspektimi, në varësi të objektit dhe subjektit ka një kohëzgjatje të caktuar, që në vazhdimësi duhet kategorizuar, për të mundësuar një programim sa më efektiv;



- b) për çdo kategori noterësh, fusha e veprimtarisë e të cilëve lidhet me një tematikë të programit vjetor, përzgjidhet në mënyrë rastësore, një numër i caktuar që do t'i nënshtrohen inspektimit;
 - c) numri i noterëve të përzgjedhur varet nga vendndodhja e tyre, bashkia, ose rendësia e posaçme e tematikës në muajin në të cilin bëhet programimi i noterëve që janë për t'u inspektuar, sipas programit paraprak vjetor;
 - d) numrin e specialistëve përgjegjës për mbikqyrjen dhe mjeteve ndihmëse të nevojshme për inspektimit. Kjo pasi në varësi edhe të distancave dhe numrit të noterëve, duhet programuar edhe nevoja për personel ose mjete mbështetëse shtesë, të cilët duhet të jenë të disponueshëm.
2. Numri i inspektimeve për çdo muaj propozohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe miratohet nga Ministri i Drejtësisë.
 3. Në çdo rast, çdo inspektim autorizohet nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 4

Programimi javor i inspektimeve

1. Programimi javor i inspektimeve bazohet mbi programimin mujor të noterëve që janë për t'u inspektuar, duke përcaktuar qartë të gjithë elementët e aktit të inspektimit, në veçanti:
 - a) noterin;
 - b) objektin/tematika sipas problematikave (tarifat, hedhja e akteve në sistem etj);
 - c) specialistët përgjegjës për mbikqyrjen;
 - ç) personat e tjerë ndihmës dhe sipas vendndodhjes, mjetet dhe automjetet në dispozicion;
 - d) kohëzgjatja;
 - dh) bashkinë ose vendndodhjen e noterit ku do të kryhet inspektimi.
2. Përcaktimi i elementëve të mësipërm, përcaktohen në mënyrë të rastisshme, në varësi të specialistëve përgjegjës për mbikqyrjen, personave të tjerë ndihmës dhe automjeteve në dispozicion që bëjnë të mundur kryerjen e inspektimit.
3. Programimi javor i inspektimeve duhet të respektojë afatet proceduriale për njoftimet në kohë dhe organizimin e inspektimit nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 5

Inspektimet e posaçme

1. Gjatë përcaktimit të programit mujor dhe javor të inspektimeve, sipas nenit 4 dhe 5, duhet të garantohet që programimi i inspektimeve të lejojë në masë të caktuar dhe të parashikojë rastet kur Ministri i Drejtësisë mund të urdhërojë inspektime të posaçme, sipas përcaktimeve nga ligji "Për noterinë".
2. Rezultatet e inspektimeve të posaçme duhet të mbahen në vëmendje në hartimin e programit vjetor të inspektimeve të vitit pasardhës, me qëllim përcaktimin e tematikave për inspektimin e noterëve, slunangien e rasteve të mbivendosjes së inspektimeve, si dhe planifikimin e ngarkesës në punës të specialistëve përgjegjës për mbikqyrjen.



Neni 6

Monitorimi i vazhdueshëm i programeve të inspektimit

1. Programet e inspektimit monitorohen në vazhdimësi, me qëllim standardizimin e elementëve të programit vjetor, mujor dhe javor.
2. Rezultatet e monitorimeve mbahen të regjistruara në një regjistër që shërben edhe për përmbledhjen e inspektimeve dhe organizimin me sa më efikasitet të tyre në të ardhmen.
3. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë raporton tek Ministri çdo fillim muaji me shkrim, për realizimin e planit të inspektimit për muajin paraardhës.

Neni 7

Përcaktimi i specialistëve përgjegjës për mbikqyrjen

1. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë duhet të organizojë, menaxhojë, përgatisë punën në mënyrë të tillë që të ketë mundësi për përcaktimin e specialistëve përgjegjës për realizimin e mbikqyrjes, në funksion edhe të efektivitetit të punës.
2. Në përmbushjen e detyrës së ngarkuar, specialistët përgjegjës për mbikqyrjen, mund të mbështeten edhe nga persona të tjerë si ekspertë të pavarur, të caktuar nga ministri sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimin përkatës.

